



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

Musa Shabani
N.P.SH. "Visa Elektro"
Emri i propozuar:
"VISA CHANEL"
Rr. Edit Durham, nr 10
Mitrovicë

Esat Ahmeti
Person Fizik
Emri i propozuar:
"TV EJA"
Shupkoc, pn
Mitrovicë

Nexhmedin Spahiu
OJQ "Mitrovica" – SH.U.D.K.P.C.
Emri i propozuar:
"TV Mitrovica"
Rr. Marie Shllaku, nr. 10

Besim Mikullovcu dhe Kushtrim Kadriu
Person Fizik
Emri i propozuar:
"MTV multivision"
Rr. Haxhi Zeka, 3/8 Prishtinë

Vendimi LIC: CIMC 2008/ag
Ref: 0808/1074/CIMC/II

VENDIM

lidhur me dhënien e licencës për transmetim për një TV lokale në gjuhën shqipe në
Komunën e Mitrovicës

Fakte

1. Këshilli i Komisionit të Pavarur për Media, në takimin e mbajtur më 9 maj 2008 ka vendosur që të diskualifikojë të gjashtë aplikacionet që kanë konkurruar në afatin e kaluar (14 shkurt – 14 mars 2008) për televizion lokal në Mitrovicë, mirëpo duke marrë parasysh rëndësinë e sigurimit të një mundësie për qytetarët e Komunës së Mitrovicës që të kenë qasje në informim televiziv në gjuhën shqipe, dhe me qëllim që të mos ketë zbrazëti të informimit televiziv të qytetarëve të kësaj komune, Këshilli i KPM-së në të njëjtin takim ka marrë vendim të ri-shpall tenderin për stacion televiziv lokal në Mitrovicë.
2. Afati për aplikim ka qenë i hapur prej datës 10 qershor 2008 deri më 10 korrik 2008. Gjatë kësaj periudhe në KPM janë paraqitur katër (4) aplikacione për shërbim transmetimi televiziv në Mitrovicë në gjuhën shqipe.

3. KPM ka pranuar aplikacionin e "VISA CHANEL" të identifikuar si "Kandidati 1T"; aplikacionin e "TV EJA" të identifikuar si "Kandidati 2T"; aplikacionin e "TV MITROVICA" të identifikuar si "Kandidati 3T" dhe aplikacionin e "MTV – multivision" të identifikuar si "Kandidati 4T".

Arsyetim

4. Neni 2.4 i Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim autorizon KPM-në mbi rregullimin e Spektrit të Frekuencave Transmetuese në Kosovë si dhe licencën transmetuesit publik dhe privat për t'i përdorur ato, në pajtueshmëri me praktikën më të mirë Evropiane, duke përfshirë pos të tjerash, zbatimin e politikës së transmetimit të përcaktuar nga Këshilli i KPM-së.
5. Sipas nenit 2.6. të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim KPM është autoriteti i vetëm në territorin e Kosovës përgjegjës për menaxhimin, rregullimin dhe caktimin e resurseve të spektrit të frekuencave të transmetimit dhe për dhënien e licencave dhe mbledhjen e taksave për shfrytëzimin e frekuencave transmetuese.
6. Neni 20.5 e autorizon KPM-në se kushdo që operon pa leje transmetuese valide t'i konfiskojë aparaturën përkatëse për transmetim. Subjekti i tillë transmetues nuk mund të ankohet tek Bordi i Ankesave për Media.
7. Këshilli i Komisionit të Pavarur për Media, i themeluar më 28 gusht 2006, ka vendosur se nuk do të shqyrtojë ndonjë kërkesë të re për licencë transmetuese deri në procesin ri-licencimit. Mirëpo, duke marrë parasysh rëndësinë e sigurimit të një mundësie për qytetarët e Komunës së Mitrovicës që të kenë qasje në informim në gjuhën shqipe, dhe me qëllim që të mos ketë zbrastim të informimit televiziv të qytetarëve të kësaj komune, KPM e ka ri-shpallur tenderin për shfrytëzimin e kanalit 42 në mënyrë që të pranohet aplikacione të përgjegjshme për një TV stacion mbulim lokal me transmetim në gjuhën shqipe në Komunën e Mitrovicës.
8. Gjatë vlerësimit të aplikacioneve të pranuara, Këshilli i KPM-së është bazuar në: kriteret e përcaktuar në tender, përmbushja e të cilave është kusht i domosdoshëm për marrjen e licencës për transmetim; në plotësimin e fletë-aplikacionit nga kandidatët si dhe në rregullën mbi "Cilësitë për Marrjen e Licencës".
9. Kriteret e vlerësimit të aplikacioneve në të cilat u bazua Këshilli i KPM-së janë:
 - a) formati dhe skema programore e propozuar, duke marrë parasysh kërkesën për atë shërbim;
 - b) Sasinë e programit lokal të prodhuar nga kandidati;
 - c) paraqitja një plani të qartë dhe praktik për organizimin dhe mbajtjen e një stacioni televiziv të angazhuar për program dhe shërbim publik për qytetarët e Mitrovicës që i përkasin shumicës shqiptare;
 - d) aftësitë profesionale për të themeluar dhe menaxhuar një TV stacion profesional dhe aftësitë e demonstruara për të financuar një TV stacion të tillë dhe
 - e) pajtueshmëria e plotë me rregullën e përgjithshme të aplikueshme të KPM-së mbi kualifikimet për një licencë.

10. Kandidati IT ka parashtruar formën e aplikimit në KPM më 10 korrik 2008, mirëpo nuk ka arritur të ofrojë një pjesë të madhe të përgjigjeve sipas fletë-aplikimit. Kandidati IT nuk ka arritur të përgjigjet fare në pikët III, IV, V dhe VI, ndërsa nuk ka ofruar gjithashtu fare përgjigje pjesa "Përmbajtja e lajmeve dhe informacionit" nën pikën IX të fletë-aplikacionit.
11. Kandidati IT planifikon që të transmetojë program kryesisht prej orës 13:00 deri në ora 01:00, që do të thotë dymbëdhjetë (12) orë në ditë.
12. Kandidati IT nuk ka ofruar sqarime konkrete lidhur me çështjet e komunitetit të cilit do t'i shërbejë si dhe lidhur me dallimin nga subjektet tjera transmetuese nuk ka ofruar të dhëna konkrete që do të mund të vlerësoheshin nga Këshilli i KPM-së. Në skemën e tij programore kandidati IT nuk ka paraqitur detaje rreth llojeve të programeve, siç kërkohet në fletë-aplikim. Gjithashtu, kandidati IT nuk ka dhënë sqarime lidhur me mënyrën e balancimit dhe të argumentimit të informacionit, siç kërkohet në fletë-aplikacion.
13. Në bazë të strukturës programore, kandidati IT ka deklaruar se do të prodhojë 30% program vetanak, mirëpo në skemën programore nuk i ka identifikuar programet të cilat do të prodhohen nga kandidati.
14. Kandidati IT planifikon t'i shërbejë kryesisht komunitetit shqiptar në Mitrovicë
15. Lidhur me sigurimin e programeve, kandidati IT nuk ka arritur të sigurojë dëshmi për bashkëpunim kompani të mediave që veprojnë brenda apo jashtë Republikës së Kosovës.
16. Këshilli i KPM-së vlerëson se kandidati IT nuk ka ofruar informacione të kënaqshme lidhur kriterin e parë mbi formatin dhe skemën programore, përfshirë edhe detajet rreth prodhimit vetanak.
17. Kandidati IT ka paraqitur një plan biznesi, mirëpo Këshilli i KPM-së vlerëson se ky plan është i pa qartë dhe i mungojnë detajet. Kandidati IT nuk ka paraqitur fare strukturë organizative.
18. Kandidati IT është pronarë i kompanisë në emër të së cilës edhe ka konkurruar dhe të njëjtën e identifikon si burim financiar dhe nga e cila planifikon të bëjë investimet për të financuar TV stacionin e propozuar. Lidhur me qëndrueshmërinë financiare kandidati IT ka ofruar për dëshmi bilancin bankar të kompanisë.
19. Kandidati IT ka paraqitur dëshmi rreth trajnimeve dhe kualifikimeve, mirëpo ato nuk kanë të bëjnë me lëmin e gazetarisë. Kandidati IT, gjithashtu ka bashkangjitur dëshmi për dy anëtarët e stafit të propozuar rreth trajnimeve dhe kualifikimeve të tyre. Kandidati IT ka aplikuar pjesërisht në pajtueshmëri me

- rregullën e përgjithshme të aplikueshme të KPM-së mbi kualifikimet për një licencë .
20. Në bazë të vlerësimit të aplikacionit, Këshilli i KPM-së ka bazë të mjaftueshme për të diskualifikuar kandidatin 1T.
 21. Kandidati 2T ka parashtruar formën e aplikimit në KPM më 9 korrik 2008, duke ofruar përgjigje sipas fletë-aplikimit.
 22. Kandidati 2T planifikon që të transmetojë program prej orës 17:00 deri në ora 23:00, që do të thotë shtatë (7) orë në ditë.
 23. Kandidati 2T ka ofruar sqarime lidhur me çështjet e komunitetit të cilit do t'i shërbejë duke dhënë një përshkrim sipërfaqësorë rreth çështjeve që konsiderohen me interes për publikun. Mirëpo, në skemën e tij programore kandidati 2T nuk ka paraqitur detaje rreth llojeve të programeve, siç kërkohet në fletë-aplikim, që do të mund të vlerësoheshin ato. Gjithashtu, kandidati 2T nuk ka dhënë sqarime lidhur me mënyrën e balancimit dhe të argumentimit të informacionit, siç kërkohet në fletë-aplikacion.
 24. Në bazë të strukturës programore, kandidati 2T ka deklaruar se do të prodhojë 28.6% program vetanak duke nënvizuar në skemën programore të gjitha programet që do të jenë prodhime vetanake të prodhuara nga kandidati.
 25. Kandidati 2T planifikon t'i shërbejë kryesisht komunitetit shqiptar, por planifikon të rezervojë hapësirë edhe për komunitetet pakicë si: komuniteti turk, boshnjak, rom e pas një periudhe edhe për atë serb.
 26. Kandidati 2T ka dhënë sqarime në mënyrë të përgjithësuar rreth dallimit nga subjektet tjera transmetuese.
 27. Lidhur me sigurimin e programeve, kandidati 2T ka arritur të sigurojë dëshmi për bashkëpunim, në përgjithësi me pesë (5) kompani të mediave që veprojnë brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës.
 28. KPM vlerëson se kandidati 2T ka ofruar informacione pjesërisht të kënaqshme lidhur kriterin e parë mbi formatin dhe skemën programore.
 29. Kandidati 2T ka paraqitur një plan biznesi të qartë dhe të detajizuar, për dymbëdhjetë (12) muaj, siç kërkohet në fletë-aplikim. Struktura organizative e paraqitur nga kandidati 2T është shumë e qartë duke ofruar të dhëna të detajizuara.
 30. Kandidati 2T është gjithashtu pronarë i një kompanie ndërtimore të cilën e identifikon si burim financiar dhe nga e cila planifikon të bëjë investimet për të financuar TV stacionin e propozuar. Lidhur me qëndrueshmërinë financiare

kandidati 2T ka ofruar për dëshmi bilancin bankar të kompanisë ndërtimore, pronarë i së cilës edhe është ky kandidat.

31. Kandidati 2T ka paraqitur një strukturë të qartë organizative në formë organogrami duke dhënë detaje dhe dëshmi rreth kualifikimeve për secilin person përgjegjës. Gjithashtu, kandidati 2T ka paraqitur dëshmi rreth angazhimit të tij në lëmin e gazetarisë. Kandidati 2T ka bashkangjitur dëshmitë e katër anëtarëve të stafit të propozuar rreth trajnimeve dhe kualifikimeve të tyre.
32. Kandidati 2T ka aplikuar në pajtueshmëri të plotë me rregullën e përgjithshme të aplikueshme të KPM-së mbi kualifikimet për një licencë.
33. Prandaj, në bazë të rezultateve gjatë vlerësimit të aplikacionit, Këshilli i KPM-së vlerëson se kandidati 2T ka arritur të paraqesë informacione të mjaftueshme, por jo të kënaqshme sa i përket detajeve në skemën programore, përfshirë edhe ato të prodhimeve programore vetanake. Në bazë të vlerësimit të Këshillit të KPM-së, kandidati 2T klasifikohet i dyti me radhë si pjesëmarrës në tenderin për TV lokale në Komunën e Mitrovicës.
34. Kandidati 3T ka parashtruar formën e aplikimit në KPM më 10 korrik 2008, duke ofruar përgjigje sipas fletë-aplikimit.
35. Kandidati 3T planifikon që të transmetojë program prej orës 07:00 deri në ora 02:00, që do të thotë nëntëmbëdhjetë (19) orë në ditë.
36. Kandidati 3T ka ofruar sqarime lidhur me çështjet e komunitetit të cilit do t'i shërbejë duke dhënë një përshkrim të detajizuar rreth çështjeve që konsiderohen me interes për publikun. Në skemën e tij programore kandidati 3T ka paraqitur detaje rreth llojeve të programeve, ashtu siç kërkohet në fletë-aplikim. Gjithashtu, kandidati 3T ka dhënë sqarime lidhur me mënyrën e balancimit dhe të argumentimit të informacionit, siç kërkohet në fletë-aplikacion.
37. Në bazë të strukturës programore, kandidati 3T ka deklaruar se do të prodhojë 100% program vetanak duke nënvizuar në skemën programore se të gjitha programet do të jenë prodhime vetanake të kandidatit.
38. Kandidati 3T planifikon t'i shërbejë të gjitha komuniteteve që jetojnë në Republikën e Kosovës duke mos vënë theks të veçantë në ndonjërin nga komunitetet.
39. Kandidati 3T ka dhënë sqarime të qarta dhe të detajizuara rreth dallimit nga subjektet tjera transmetuese.
40. Lidhur me sigurimin e programeve, kandidati 3T deklaroi se i tërë programi i transmetuar do të jetë prodhim vetanak.

41. KPM vlerëson se kandidati 3T ka ofruar informacione të kënaqshme lidhur me kriterin e parë mbi formatin dhe skemën programore, përfshirë edhe detajet rreth llojeve të programeve.
42. Kandidati 3T ka paraqitur një plan biznesi të qartë dhe të detajizuar për dymbëdhjetë (12) muaj, ashtu siç kërkohet në fletë-aplikim.
43. Lidhur me qëndrueshmërinë financiare kandidati 3T ka ofruar për dëshmi bilancin bankar të organizatës joqeveritare të cilën kandidati e drejton. Gjithashtu, kandidati 3T ka ofruar dëshmi se posedon të gjitha pajisjet e duhura për të filluar transmetimin televiziv.
44. Kandidati 3T ka paraqitur një strukturë të qartë organizative në formë organogrami duke dhënë detaje dhe dëshmi rreth kualifikimeve për secilin person përgjegjës në menaxhimin e stacionit televiziv. Gjithashtu, Kandidati 3T ka paraqitur dëshmi mbi kualifikimet akademike dhe dëshmi rreth angazhimit të tij në lëmin e gazetarisë. Kandidati 3T ka bashkangjitur dëshmitë e dyzet e pesë (45) anëtarëve të stafit të propozuar rreth trajnimeve dhe kualifikimeve të tyre.
45. Kandidati 3T ka aplikuar pjesërisht në pajtueshmëri me rregullën e përgjithshme të aplikueshme të KPM-së mbi kualifikimet për një licencë.
46. Këshilli i KPM-së vlerëson se aplikacioni i kandidatit 3T ka ofruar informacione të kënaqshme lidhur me aftësitë profesionale dhe menaxheriale për udhëhequr me një stacion televiziv lokal duke paraqitur një skemë programore e cila është bindëse për KPM-në që do t'i shërbejë interesave të qytetarëve të Komunës së Mitrovicës në përgjithësi. Në bazë të vlerësimit të Këshilli i KPM-së, kandidati 3T klasifikohet i pari me radhë si pjesëmarrës në tenderin për TV lokale në Mitrovicë.
47. Kandidati 4T ka parashtruar formën e aplikimit në KPM më 10 korrik 2008, duke ofruar përgjigje sipas fletë-aplikimit.
48. Kandidati 4T planifikon që të transmetojë program prej orës 07:00 deri në ora 24:00, që do të thotë shtatëmbëdhjetë (17) orë në ditë.
49. Kandidati 4T ka ofruar sqarime lidhur me çështjet e komunitetit të cilit do t'i shërbejë duke dhënë një përshkrim të detajizuar rreth çështjeve që konsiderohen me interes për publikun. Në skemën e tij programore kandidati 4T ka paraqitur detaje rreth llojeve të programeve. Kandidati 4T ka dhënë sqarime sipërfaqësore, por jo konkrete, lidhur me mënyrën e balancimit dhe të argumentimit të informacionit.
50. Në bazë të strukturës programore, kandidati 4T ka deklaruar se do të prodhojë 30% program vetanak, mirëpo nuk ka nënvizuar në skemën programore se cilat programe do të jenë prodhime vetanake të kandidatit.

51. Kandidati 4T planifikon t'i shërbejë kryesisht shumicës shqiptare, mirëpo duke mos përjashtuar mundësinë e shërbimit për komunitetin turk, boshnjak dhe romë, gjithashtu në një të ardhme kandidati 4T planifikon të ofrojë programe edhe për komunitetin serb.
52. Kandidati 4T ka dhënë sqarime të detajizuara rreth dallimit nga subjektet tjera transmetuese, duke i vënë theks të veçantë programeve për fëmijë.
53. Lidhur me sigurimin e programeve, kandidati 4T ka ofruar dëshmi nga agjencitë e lajmeve për mbështetjen e tyre.
54. Këshilli i KPM-së vlerëson se kandidati 4T ka ofruar informacione pjesërisht të kënaqshme lidhur kriterin e parë mbi formatin dhe skemën programore.
55. Kandidati 4T ka paraqitur një plan biznesi, mirëpo i njëjti nuk është i qartë dhe i detajizuar mirë, ashtu siç kërkohet në fletë-aplikim.
56. Lidhur me qëndrueshmërinë financiare kandidati 4T ka ofruar për dëshmi gjashtë para-kontrata me kompani të ndryshme.
57. Kandidati 4T ka paraqitur një strukturë të qartë organizative në formë organogrami duke dhënë detaje për secilin person përgjegjës në menaxhimin e stacionit televiziv. Gjithashtu, kandidati 4T ka paraqitur dëshmi rreth angazhimit të tij në lëmin e gazetarisë. Kandidati 4T ka bashkangjitur dëshmitë e katërmbëdhjetë (14) anëtarëve të stafit të propozuar rreth trajnimeve dhe kualifikimeve të tyre.
58. Kandidati 4T ka aplikuar pjesërisht në pajtueshmëri me rregullën e përgjithshme të aplikueshme të KPM-së mbi kualifikimet për një licencë.
59. Këshilli i KPM-së vlerëson se kandidati 4T ka ofruar informacione të mjaftueshme për vlerësim të aplikacionit, por një pjesë e tyre nuk mund të konsiderohen si informacione bindëse për skemën programore në përgjithësi, e në veçanti identifikimi të programeve vetanake në skemën programore, si dhe mungesa e detajeve për programet vetanake. Qëndrueshmëria financiare dhe aftësia menaxheriale për të udhëhequr me një televizion lokal nuk është bindëse. Gjithashtu, çështja e pronësisë nuk është e detajizuar mirë dhe lë vend për paqartësi. Në bazë të vlerësimit të Këshilli i KPM-së, kandidati 4T klasifikohet i treti me radhë si pjesëmarrës në tenderin për TV lokale në Mitrovicë.

Vendim

60. Më 1 gusht 2008, Këshilli i KPM-së konkludon se kandidati 3T, në krahasim me të gjithë kandidatët tjetër që kanë konkurruar gjatë periudhës së tenderit, është kandidati më i kualifikuar dhe në bazë të vlerësimit të aplikacionit kandidati 3T do të jetë në gjendje të operojë dhe të menaxhojë me një stacion lokal televiziv në

gjuhën shqipe në Komunën e Mitrovicës. Gjithashtu, Këshilli i KPM-së konkludon se kandidati 3T ka demonstruar aftësi për të bërë transmetim profesional që do t'i shërbejë nevojave dhe interesave të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Komunën e Mitrovicës.

61. Këshilli i KPM-së gjen se kandidati 1T nuk është përgjigjur fare në pikët III, IV, V dhe VI të fletë-aplikimit, ndërsa nuk ka ofruar fare përgjigje tek pjesa "Përmbajtja e lajmeve dhe informacionit" nën pikën IX të fletë-aplikacionit. Pra, në mungesë të të dhënave të mjaftueshme Këshilli i KPM-së konkludon se kandidati 1T është i papërgjegjshëm prandaj edhe ka vendos që ta diskualifikojë nga tenderi për TV lokale në Komunën e Mitrovicës.
62. Kandidatët 2T dhe 4T kanë parashtruar aplikacionet të kompletuara, mirëpo që të dy këta kandidatë nuk kanë arritur të ofrojnë detaje rreth skemës programore, siç kërkohet me fletë-aplikacion. Gjithashtu, kandidati 2T i mungojnë detajet rreth prodhimit të programit vetanak ndërsa kandidati 4T nuk ka paraqitur fare strukturë organizative. Kandidati 2T ka ofruar dëshmi për katër (4) anëtarë të stafit ndërsa kandidati 4T ka ofruar dëshmi për katërmbëdhjetë (14) anëtarë të stafit të propozuar dhe se Këshilli i KPM-së vlerëson se të dy këta kandidatë kanë paraqitur një numër të pamjaftueshëm të stafit për dallim nga kandidati 3T.
63. Kështu që, Këshilli i KPM-së vendos që kandidatin 2T ta klasifikojë të dytin me radhë, ndërsa kandidatin 4T ta klasifikojë të tretin me radhë në këtë tender.
64. Për dallim prej kandidatëve 2T dhe 4T, kandidati 3T ka arritur të ofrojë sqarime të detajuara rreth skemës programore si dhe ka paraqitur detaje rreth programit vetanak. Kandidati 3T ka paraqitur një strukturë të qartë organizative dhe një plan të qartë biznesi për 12 muajt e ardhshëm, siç kërkohet në fletë-aplikacion. Sa i përket anëtarëve të stafit të propozuar, kandidati 3T ka paraqitur të dhëna për dyzetepesë (45) anëtarë, duke bashkangjitur edhe dëshmi rreth trajnimeve të tyre në lëmin e gazetarisë.
65. Prandaj, Këshilli i KPM-së merr vendim që kandidatin 3T ta klasifikojë të parin me radhë duke marrë parasysh se i njëjti i ka ofruar të dhëna të besueshme duke përmbushur kriteret për të marrë licencë të përkohshme deri në fazën e ri-licencimit për transmetim lokal televiziv në Komunën e Mitrovicës.
66. Prandaj, në mënyrë unanime Këshilli i KPM-së merr vendim që licenca për stacion televiziv me mbulim lokal, për transmetim në gjuhën shqipe në Komunën e Mitrovicës, t'i lëshohet kandidati 3T, emri i propozuar "TV Mitrovica", me pronarë OJQ "Mitrovica", drejtor i së cilës është z. Nexhmedin Spahiu.
67. Këshilli i KPM-së do të paraqesë kriteret e aplikimit për procesin e ri-licencimit, gjithashtu edhe kushtet dhe termet për licenca afatgjate. Këto kritere do të bëhen publike dhe do të jenë të zbatueshme për të gjithë kandidatët që konkurrojnë.

Ankesa

68. Në pajtim me nenin 21.3 të Ligjit të KPM-së, Bordi Ankesave për Media (“Bordi”) mund të dëgjojë dhe vendos ankesat për vendimet e më poshtme të Këshillit të KPM-së:

- a. dhënies, refuzimit, mos ripërtëritjes ose revokimit të lejes transmetuese;
- b. vënies ose ndryshimit të kushteve të lejes së transmetimit, me përjashtim të kushteve që kanë të bëjnë me caktimin e frekuencave apo kritereve të tjera teknike;
- c. shqiptimit të sanksioneve; dhe
- d. çështjeve tjera të ngjashme që mbështeten në urdhëresat administrative dhe rregulloren.

69. Neni 25.1 i Ligjit të KPM-së kërkon që Ankesat t’i parashtrihen Bordit të Ankesave brenda tridhjetë ditësh nga nxjerrja e vendimit. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkoen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 24.2 (a) të Ligjit të KPM-së.

70. Bordi gjithashtu ka përcaktuar rregullat e tij të procedurës. Rregullat e procedurës së Bordit janë në dispozicion nga zyra e Shefit Ekzekutiv të KPM-së sipas kërkesës.

Lëshimi i Vendimit

71. Këshilli i KPM-së e lëshon këtë vendim



Argjentina Grazhdani
Kryesuese e Këshillit të KPM-së

04/08/08
datë

Vërtetim

Më këtë vërtetohet se Këshilli i KPM-së ka marrë këtë vendim në pajtueshmëri me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë, dhe në pajtueshmëri me rregullat e procedurës së KPM-së.



Naile Selimaj Krasniqi
Shefe Ekzekutive



04.08.08
datë